### Propozimi Ekonomik do të ketë 20 pikë

Pe- Pikët për Propozimin Ekonomik

Çu- Çmimi më i Ulët i Ofruar

Ç – Çmimi Ofertues i Radhës (*duke filluar nga çmimi më i ulët*)

$$Pe = 100 \times \frac{\text{Çu}}{\text{Ç}}$$

(çmimi më i ulët = pikët maksimale për propozimin ekonomik)

### Vlerësimi përfundimtar

Peshat për Propozimet Teknike dhe Financiare janë dhënë si më poshtë:

**Pesha për Propozimin Teknik: X = (pikët e propozimit teknik x 0.8)**

**pesha për Propozimin Ekonomik:  $Y = (\text{pikët e propozimit ekonomik} \times 0.2)$**

Oferta më e mirë do të jetë sipas kombinimit të pikëve të propozimit teknik dhe propozimit ekonomik. Formula e llogaritjes është si më poshtë:

$$\text{Oferta më e mirë} = X + Y$$

**Opsioni 2) – Oferta Ekonomikisht më e Favorshme, Bazuar në Çmim:**

Kontrata do t'i jepet ofertuesit i cili ka ofruar çmimin më të ulët të ofertës së kualifikuar.

**SHENIM: 1.** Autoriteti/Enti Kontraktor do të zgjedhë vetëm një nga Opsionet si kriter i vlerësimit. Përdorimi i të dy opsioneve në DT e bën procedurën të pavlefshme.

2. Autoriteti/Enti Kontraktor përdor si kritere vlerësimi një nga kriteret e përcaktuara në Njoftimin e Kontratës.

3. Autoriteti/Enti Kontraktor do t'i japë kontratën Operatorit Ekonomik, Oferta e të cilit ka rezultuar të jetë ekonomikisht më e favorshme.

**26. Korrigjimi i gabimeve aritmetike dhe ofertave anomalisht të ulëta**

1. Autoriteti/Enti Kontraktor kontrollon ofertat e paraqitura nëse kanë gabime aritmetike. Nëse ofertat rezultojnë me gabime aritmetike, autoriteti/enti i korrigjon këto gabimesi më poshtë:

- (a) Nëse ka ndonjë mospërputhje midis çmimit për njësi dhe çmimit total, që rezultojnë nga shumëzimi i çmimit të njësisë me sasinë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij. Në këtë rast, do të korrigjohet edhe shuma në fjalë, e cila ka lidhje me gabimin.
- (b) Nëse ka ndonjë mospërputhje tek çmimi total, kur totali është shuma ose diferenca e nëntotaleve, çmimi i nëntotalit mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij. Në këtë rast, do të korrigjohet edhe shuma në fjalë, e cila ka lidhje me gabimin.
- (c) Nëse ka ndonjë mospërputhje ndërmjet shumës në fjalë dhe shumës në shifra, mbizotëron shuma në fjalë. Bën përjashtim nga ky rregull situata kur, shuma në fjalë ka mospërputhje me shumën në shifra, ndërkohë që kjo e fundit nuk ka gabime aritmetike në përlllogaritjen e zërave të ofertës.

Në çdo rast, Ofertat me gabime aritmetike refuzohen kur:

- shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar;
- shuma absolute e të gjitha korrigjimeve është më pak se 2%, por nuk pranohet korrigjimi nga ofertuesi.

2. Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur.

- Në rast kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i refuzon ato, duke i skualifikuar nga procedura, pa i kërkuar sqarim ofertuesit/sve.

Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet ti kërkojë operatorit ekonomik të paraqesë brenda tre ditëve pune, shpjegime të çmimit ose kostove të propozuara në ofertë, në përputhje me nenin 93 të LPP-së dhe të vlerësojnë informacionin e dhënë, në konsultim me ofertuesin, në përputhje me dispozitat e këtij neni.

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të justifikojë dhe dokumentojë me prova me shkrim, shpjegime për elementin/elementët specifike të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93 të LPP-së.

**2.1** Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

**O - Oferta**

**MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme**

**N - Numri i ofertave të vlefshme**

**PR (Zm) – Zbritje e mundshme**

**MO = O1 + O2 + O3 + ... On / N**

**PR = 85 % Mo**

**Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR ..... rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët**

3. Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korrigjimin e gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin/Entin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

4. Procesi i hedhjes së shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

## **D. DHËNIA E KONTRATËS**

### **27. Njoftimi i Fituesit**

Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti/Enti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.

**28. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/Kontratës** i 1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti/Enti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.

2 Autoriteti/Enti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.

Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:

- a) mundësi pagese nga ofertuesi në vlerë monetare, në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor;
- b) garanci bankare
- c) garanci nga shoqëri sigurimi.

#### **DH. ANKESAT**

**29. Procedura e ankesës** 1 Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes të ligjshëm për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin dhe /ose përzgjedhjen e operatorëve ekonomikë për t'u ftuar për të paraqitur oferta, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore, në Sistemin e Ankesave Elektronike.

2. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit ose entit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, në Sistemin e Ankesave Elektronike.

Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik

3 Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

#### **E. ANULIMI I PROCEDURËS**

**30 Anulimi i procedurës** i 1 Autoriteti / Enti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.

2. Autoriteti/ entit kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:

- a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;
- b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;

c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;

d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;

e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021 të ndryshuar.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të pikës 2, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

4. Nëse Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me rishpalljen e saj në sistemin e prokurimit elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

---

## SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

- Shtojca 1. Formulari i Kërkesës për Pjesëmarrje
- Shtojca 2. Ftesa për Ofertë për Kandidatët e përzgjedhur, faza II
- Shtojca 3. Formulari i Ofertës Ekonomike
- Shtojca 4. Lista e Çmimeve sipas Elementëve Përbërës të Shërbimit
- Shtojca 5. Formulari i Sigurimit të Ofertës
- Shtojca 6. Lista e Informacionit Konfidencial
- Shtojcë 7. Deklaratë mbi disponueshmërinë e Anëtarit të Stafit
- Shtojca 8. Formulari i Specifikimeve Teknike
- Shtojca 9. Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit
- Shtojca 10. Formulari i Termave të Referencës
- Shtojca 11. Formulari i Kritereve Përzgjedhjes së Ofertuesve
- Shtojca 12. Formulari i Përmbledhës i Vetdeklarimit
- Shtojca 13. Formulari i Njoftimit të skualifikimit
- Shtojca 14. Formulari i Njoftimit të Fituesit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit.
- Shtojca 15. Formulari i Njoftimit të Fituesit në përfundim të afateve të ankimit
- Shtojca 16. Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit.
- Shtojca 17. Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër në përfundim të afateve të ankimit.
- Shtojca 18: Formulari i Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit.

**Shtojca 1**

*(Shtojca për t'u paraqitur nga Operatori Ekonomik)*

**FORMULARI I KËRKESES PËR PJESËMARRJE**

Emri i **Operatorit Ekonomik** \_\_\_\_\_

Drejtuar: *[Emri dhe adresa e autoritetit /entit kontraktor]*

\* \* \*

Procedura e prokurimit: *[lloji i procedurës]*

Numri i referencës së procedurës / referenca e Lotit

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Botimi (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike [Data]

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, në, të nënshkruarit paraqesim shprehjen tonë të interesit për të marrë pjesë në këtë procedurë.

**Emri i Përfaqësuesit të Ofertuesit**

**Nënshkrimi**

**Vula**

**Shtojca 2**

*(Shtojcë për tu plotësuar nga autoriteti /enti kontraktor vetëm për operatorët ekonomikë të kualifikuar/  
përzgjedhur bazuar në kerkesën për pjesëmarrje)*

**FORMULAR I FTESËS PËR OFERTË**

[Datë]

Drejtuar: *[Emri dhe adresa e operatorit ekonomik të kualifikuar /përzgjedhur]*

Procedura e prokurimit \_\_\_\_\_/

Numri i procedurës / referenca e Lotit \_\_\_\_\_

Në referencë të procedurës së lartpërmendur ju bëjmë me dije se [emri dhe adresa e kandidatit të përzgjedhur], pas vlerësimit të dokumentacionit të paraqitur në fazën e parë, Ju jeni kualifikuar për fazën ofertuese të kësaj procedure prokurimi.

Për këtë arsye, ju kërkojmë të paraqisni pranë [këtij autoriteti/enti kontraktor]

Emri \_\_\_\_\_

Adresa \_\_\_\_\_

Ofertën tuaj, duke marrë në konsideratë si më poshtë:

**Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertës është:**

Data (d/m/v)

Ora: \_\_\_\_\_

Adresa \_\_\_\_\_

Kur oferta kërkohet të paraqitet me mjete elektronike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin ofertën në formë elektronike në ueb-faqen zyrtare të APP, [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al).

**Informacioni mbi ofertat e paraqitura me mjete elektronike i transmetohet të gjithë atyre Operatorëve Ekonomikë që kanë dorëzuar oferta, në bazë të kërkesës së tyre.**

**Gjuha (ët) e hartimit të ofertës është:**

Shqip       Anglisht

Tjetër \_\_\_\_\_

### Kriteret e përzgjedhjes së fituesit

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit janë si më poshtë:

#### A) <sup>4</sup>oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto

Sipas rëndësisë:

Çmimi       pikët

\_\_\_\_\_  pikët

\_\_\_\_\_  pikët

\_\_\_\_\_  pikët

Autoriteti/enti kontraktor duhet të specifikojë pikët për cdo kriter vlerësimi të përcaktuar.

### OSE

#### B) oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

**Në rastin e Marrëveshjes Kuadër, kur do të përdoret kriteri i vlerësimit të çmimit për njësi, për qëllime krahasimi, vlerësimi i ofertave do të kryhet në bazën e shumës së çmimeve për njësi (Kjo metodë e vlerësimit nuk do të përdoret nga autoritetet/entet kontraktore në rastet kur sasi të janë të vlerësueshme në bazë vjetore sipas përvojës së mëparshme dhe kur Marrëveshja Kuadër është përdorur për prokurimin e mallrave dhe shërbimeve të vazhdueshme. Në rast të tillë çmimi më i ulët do të vlerësohet me vlerën totale më të ulët ofruar).**

Mbetemi në pritje të marrjes së ofertës suaj.

**[Drejtuesi i autoritetit /entit kontraktor]**

<sup>4</sup> Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehesh në shifra. Në çdo rast, kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të çmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100 pikë. Në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme, kriter për shpalljen e ofertës fituese do të jetë “oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto”, ku çmimi do të ketë 20 pikë dhe propozimi teknik 80 pikë.

### Shtojca 3

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik i ftuar për të paraqitur ofertën)

#### FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE<sup>5</sup>

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:*[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]*, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- b) Ne *[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]*, nuk jemi -të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës *[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]*.
- c) Ne ofrojmë të kryejmë për Autoritetin/Entin Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
  1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
  2. Njoftimin e kontratës;
  3. Kriteret e përzgjedhjes;
  4. Specifikimet teknike, grafiku i ekzekutimit;
  5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
  6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
  7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.

---

<sup>5</sup> Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

- e) Çmimi total i Ofertës sonë, pa TVSH, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];

<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>	
<b>Nënshkrimi</b>	
<b>Vula</b>	
<b>Datë</b> _____	

**Shtojca 4.***(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT****Data:** \_\_\_\_\_**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:** \_\_\_\_\_**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** \_\_\_\_\_**Monedha:** \_\_\_\_\_

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementët përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të çojnë në refuzimin e ofertës.

**Lista e Çmimeve**

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>5</i>	
<b>Nr</b>	<b>Përshkrimi i elementëve përbërës të Ofertës Ekonomike</b>	<b>Sasia</b>	<b>çmimi për njësi</b>	<b>Çmimi total (3 x 4X)</b>	
1.					
2.					
3.					
4					
	<b>Çmimi total</b>				_____
<b>Çmimi Neto pa TVSH</b>					
<b>TVSH (%)</b>					
<b>Çmimi total me TVSH:</b>					
<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>					

---

<b>Nënshkrimi</b>	
<b>Vula</b>	
<b>Datë</b> _____	

**Shtojca 5.**

[ *Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik*]  
 [ *Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve* ]

**FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS**

Për: [ *Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor* ]

Në emër të: [ *Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar* ]

\* \* \*

Procedura e prokurimit [ *lloji i procedurës* ]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [ *objekti* ]

Publikimi ( *nëse zbatohet* ): Buletini i Njoftimeve Publike [ *Data* ] [ *Numri* ] / Nr. Referencës në faqen e APP-  
 se

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

*Ne vërtetojmë se [ emri i ofertuesit të siguruar ] ka derdhur një depozitë pranë [ emri dhe adresa e bankës ] / është garantuar pranë [ emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit ] me një vlerë prej [ monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra ] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.*

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [ *emri i autoritetit/entit kontraktor* ] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentet e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentet e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [ *njoftimin e kontratës* ].

**[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]**

## Shtojca 6

(Shtojce për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

### Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial )

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

### VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

### Përfaqësuesi i Ofertuesit

#### Nënshkrimi

#### Vula

**Shtojca 7**

(<sup>6</sup>Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik)

**DEKLARATË****Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit**

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë \_\_\_\_\_ nga Autoriteti/Enti Kontraktor \_\_\_\_\_ me objekt \_\_\_\_\_ me fond limit \_\_\_\_\_.

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik “.....” për procedurën e prokurimit me objekt \_\_\_\_\_ nën përgjegjësinë time personale, **Deklaroj** se:

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik “.....” të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë \_\_\_\_\_ nga Autoriteti/Enti Kontraktor \_\_\_\_\_ me objekt \_\_\_\_\_ me fond limit \_\_\_\_\_.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e prokurimit me objekt ....., është i pamiratur dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

**Data e dorëzimit të deklaratës** \_\_\_\_\_

**Emri, Mbiemri, Nënshkrimi**

**Vula**

<sup>7</sup> Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme

**Shtojca 8.**

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor ]

**FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE****“FURNIZIMI I SHËRBIMIT TË LAVANDERISË PËR SPITALIN RAJONAL DURRËS”****1. Specifikat e shërbimit**

Operatori ekonomik privat që do të kontraktohet duhet të ofrojë një shërbim sipas grafikëve të përcaktuar nga AK, rregulloreve dhe protokolleve të higjienës, si dhe manualeve të kujdesit spitalor, i cili do të përfshijë:

- a. Grumbullimin e materialit të butë të papastër në të gjitha pavionet e Spitalit Rajonal Durrës (SRD);
- b. Larjen e materialit të butë;
- c. Dezinfektimin e materialit të butë;
- d. Tharjen e materialit të butë;
- e. Hekurosjen dhe paketimin e materialit të butë;
- f. Shpërndarjen e materialit të butë në të gjitha shërbimet dhe pavionet e SRD;
- g. Ndërrimin dhe shtrimin e shtratit të pacientit;
- h. Shërbimi do të ofrohet gjatë gjithë javës, nga dita e hënë deri në ditën e diel, duke përfshirë edhe ditët e festave.

**2. Numri total i shtretërve që duhet të pajisen me bazë materiale dhe që duhet të mbulohen nga shërbimi i lavanderisë është si më poshtë:**

		Nr. Shtreter pavion	Kabinete	Dhome mjeku	Barrela/shtrat vizite/Poltrona	Shtrat salle operacioni	Krevat salle lindje	Dyshek
<b>I</b>	<b>Sherbimi i semundjeve te brendshme</b>							
1	Patologji	40	12	1	Për Kabinet vetem peshqire			42
2	Reanimacioni Kardiologji	10		1				11
3	Kardiologji	30	1		3			30
4	Neurologji	30		2				32
5	Paliativi	4			9			4
6	Infektivi Madh	<b>20</b>	20 shtreter Emergjence					40
<b>II</b>	<b>Sherbimi i Kirurgjise</b>							
7	Kirurgji	36	5		2			36
8	Reanimacion Kirurgjia	14						14

9	Ortopedi/Fizioterapi	20	6		1			20
10	ORL/ Maxillo-Faciale	20	6					20
<b>III</b>	<b>Sherbim Urgjence</b>							
11	Pranim Urgjence	22	2	2	6			25
12	Salla Operacionit Urgjence			2	3	10		2
13	Ambulancat	10						Dyshek
14	Radiologji	2		1	3			2
15	Morgu	1						
<b>IV</b>	<b>Sherbimi Maternitetit</b>							
16	Obstetrike	74		2	2		4	76
17	Konsultori Gruas	4	2		2			4
18	Reanimacion Maternitet	7						7
19	Sektori koordinimit me pacientin							
	<b>TOTALI Nr</b>	<b>354</b>	<b>34</b>	<b>11</b>	<b>31</b>	<b>10</b>	<b>4</b>	<b>365</b>

		Nr. Shtreter Pavion	Shtreter 0-5 vjec	Shtreter 5-14 vjec	Barrela/shtrat vizite/kabinete	Shtrat i madh spitalor	Dhome mjeku	Dyshek
<b>V</b>	<b>Sherbimi Peditrise</b>	<b>87</b>	<b>total shtreter sherbimi peditrise</b>					<b>89</b>
1	Pediatrica Somatike		12	58	15	18	1	
2	Infektiv i peditrise							
	<b>TOTALI Nr</b>		<b>12</b>	<b>58</b>	<b>15</b>	<b>18</b>	<b>1</b>	

		Nr. Shtreter Pavion	Krevat inkubatori	Dhome mjeku	Barrela/shtrat vizite/poltrona	Dyshek inkubatori 8 cope	Dyshek bebi Pavioni 36 copë	Dyshek mjek MJEK
<b>IV</b>	<b>Sherbimi Maternitetit</b>					<b>Përmasat</b>	<b>Përmasat</b>	
1	Neonate	36	8	1	6	61*33*2	60*35*5	1
	<b>TOTALI Nr</b>							

➤ **Materiali i butë sipas kërkesave të shërbimeve dhe pavioneve**

		DYSHEK BARRELE	CARCAF DYSHEKU	MBROJTESE	CARCAF JORGANI	KELLEJ JASTEKU	MBROJTESE	BATANJE	PESHQIR	JORGAN	JASTEK	CARCAF SALLE	KOMPRESA SALLE	PERPARESE	UNIFORMA	PIZHAMA	FUSTANE	Dyshek Krevet Lindje	GARZA	PANDOFLA	KOORDINATORET
<b>I</b>	<b>SHERBIMI S/BRENDSHME</b>																				
1	Patologji		1	1	1	1			1	1	1			1	1	1	1				
2	Reanimacioni Kardiologji		1	1	1	1			1	1	1			1	1	1	1			1	
3	Kardiologji	1	1	1	1	1			1	1	1			1	1	1	1			1	
4	Neurologji		1	1	1	1			1	1	1			1	1	1	1			1	
5	Paliativi		1	1	1	1		1	1	1	1			1	1					1	
6	Infektivi Madh		1	1	1	1			1	1	1			1	1	1	1			1	
<b>II</b>	<b>SHERBIMI KIRURGJISE</b>																				
7	Kirurgji		1	1	1	1			1	1	1			1	1	1	1			1	
8	Reanimacion Kirurgjia		1	1	1	1		1	1	1	1			1	1	1	1			1	
9	Ortopedi/FIZI OTERAPI		1	1	1	1			1	1	1			1	1	1	1			1	
10	ORL/ Maxillo- Faciale		1	1	1	1			1	1	1			1	1	1	1			1	
<b>III</b>	<b>SHERBIMI URGJENCE</b>																				
11	Pranim Urgjence	6	1	1				1	1					1	1					1	
12	Salla Operacionit Urgjence	3	1	1	1	1			1	1	1	1	1	1	1					1	
13	Ambulancat		1																		
14	Radiologji		1	1	1	1			1	1	1			1	1					1	
15	Morgu		1						1												
<b>IV</b>	<b>SHERBIMI MATERNITETIT</b>																				
16	Obstetrike		1	1	1	1	1		1	1	1	1	1	1	1		1		1	1	
17	Konsultori Gruas		1	1		1		1	1					1	1					1	

18	Reanimacion Maternitet		1	1	1	1				1	1			1	1				1		
19	Sektori koordinimit me pacientin																			5	
			CARCAF PEDIATRIE 0-5	CARCAF PEDIATRIE 5-	CARCAF MANIPULIMI	MBROJTESE DYSHEKU	MBOJTESE DYSHEKU 5-	CARCAF JORGANI 0-5	CARCAF JORGANI 5-14	KELLEF JASTEKU	BATANIJE DIMERORE 5-	PESHQIR	BATANIJE DIMERORE 0-	JORGAN 5-14 VJEC	JASTEK	PERPARESE	UNIFORMA	BATANIJE VERORE 0-5	JORGAN MJEK	Carcaf zarf 140 *180	JASTEK MJEK
<b>V</b>	<b>SHERBIMI PEDIATRISE</b>																				
1	Pediatria Somatike	8 9	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1
2	Infektivi i pediatrie		1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1

			CARCAF DYSHEKU	CARCAF FANELLATE	DYSHEK 60x35x5	GUVERTE VERORE	BATANIJE DIMERORE	PESHQIR	GARZA PER TE	KAPUCE	MBROJTESE SYSH UV	MBAJTESE TRUPI	PERPARESE	UNIFORMA	DYSHEK MJEK	CARCAF DYSHEKU	CARCAF ZARF MJEK	KELLEF JASTEKU	JORGAN	JASTEK	
<b>IV</b>	<b>SHERBIMI MATERNITETIT</b>																				
1	Neonate		1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1

➤ **Totali i numrit të shtretërve nga shërbimet dhe pavionet që marrin shërbim lavanderie**

Nr rendor	Emërtesa	Nr.
1	Shttrat salle operacioni	14
2	Barrela/shtrat vizite/poltrona	52
3	Dhome Mjek	13
4	Total shtreter SRD	477
	<b>Total shtreter qe marrin Sherbim Lavanderie</b>	<b>556</b>

### 3- Lloji i materialeve të buta për larje

Referuar standardeve dhe protokolleve për shërbimet spitalore, në vijim janë të detajuara llojet e materialit të butë që do të lahen.

#### ➤ Emërtimet e Materialit të butë që përdoren në Shërbimet për të rritur

Çarçaf dysheku	Dyshek spitalor
Mbrojtëse dysheku	Dyshek krevat lindje
Çarçaf jorgani	Garza
Këllëf jastëku	Pandofla sallë
Guverta verore	Pandofla
Batanije dimërore	Çarçaf sallë maternitet
Peshqir	Kompresa sallë maternitet
Jorgan	Përparëse
Jastëk	Uniforma
Çarçaf sallë urgjencë	Pizhama
Kompresa sallë urgjencë	Robdisham adult
Fustane	–

Këto janë emërtimet e materialit të butë që janë pjesë e kontratës në ekzekutim për Shërbimin e Lavanterisë për të Rritur.

#### ➤ Emërtimet e Materialit të butë që përdoren në Shërbimin e Pediatriisë.

Çarçaf pediatrik 0–5 vjeç	Peshqir
Çarçaf pediatrik 5–14 vjeç	Batanije dimërore 0–5 vjeç
Çarçaf manipulimi	Jorgan 5–14 vjeç
Mbrojtëse dysheku 0–5 vjeç	Jastëk
Mbrojtëse dysheku 5–14 vjeç	Uniforma
Çarçaf jorgani 0–5 vjeç	Jastëk
Çarçaf jorgani 5–14 vjeç	Përparëse
Këllëf jastëku	Batanije verore 0–5 vjeç
Guverta verore	Çarçaf zarf mjek 140×180
Batanije dimërore	Dyshek 0–5 vjeç
Dyshek 5–14 vjeç	Dyshek spitalor për të rritur

Këto janë materialet e buta që janë pjesë e kontratës në ekzekutim për Shërbimin e Lavanterisë për Shërbimin e Pediatriisë .

➤ **Emërtimet e Materialit të butë që përdoren në Shërbimin e Neonatologjisë.**

Çarçaf dysheku 120×150	Çarçaf dysheku mjek
Çarçaf fanellate 120×150	Çarçaf zarf mjek
Dyshek 60×35×35	Këllëf jastëku mjek
Dyshek 87×50×40	Guverta verore mjek
Guverta verore	Përparëse
Batanije dimërore	Uniforma
Peshqir	Mbrojtëse sysh UV
Garza për të vjellat	Mbajtëse trupi
Kostume neonat	Dyshek inkubatori

Këto janë materialet e buta që janë pjesë e kontratës në ekzekutim për Shërbimin e Lavanterisë për Shërbimin Neonatologjisë.

**1. Shpeshtësia e ndërrimit të materialit të butë**

Ndërrimi i shtratit të pacientit do të bëhet çdo 3–4 ditë, si dhe në çdo rast që kërkohet nga kryeinfermier(i) i pavionit/shërbimit, si pasojë e shtrimit të pacientëve të rinj (me hapjen e kartelës klinike), ose në rastet kur ndryshimi i shtratit bëhet i domosdoshëm për të ruajtur dhe mbrojtur shëndetin e pacientit.

Në tabelën në vijim jepet e detajuar shpeshtësia e ndërrimit të materialit të butë në disa prej shërbimeve të SRD-së:

**Tabela 2. Shpeshtësia e ndërrimit të materialit të butë**

Nr.	Përshkrimi i shërbimit	Shpeshtësia e ndërrimit të materialit të butë
1	Shtretër për pacientët e hospitalizuar	1 herë çdo 3–4 ditë
2	Shtretër për shërbimet e urgjencave	Sa herë të jetë e nevojshme
3	Shtretër për shërbimin e reanimacioneve	Sa herë të jetë e nevojshme
4	Shtretër për shërbimin paliativ	1 herë në ditë
5	Shtretër neonatologjie	Sa herë të jetë e nevojshme
6	Shtretër për mjekët roje	1 herë në ditë
7	Ambulanca	Sa herë të jetë e nevojshme
8	Morgu	Sa herë të jetë e nevojshme

Duke pasur parasysh shpërndarjen aktuale të shtretërve në SRD, si dhe përqindjen e shfrytëzimit të shtratit sipas shërbimeve të ndryshme, tabela në vijim jep një pamje të numrit të shtretërve, të cilët janë të domosdoshëm për t'u kompletuar me inventar të butë nga Operatori Ekonomik:

**1. Përqindja e zënies së shtratit**

Dhoma që do të marrin shërbim mesatarisht, në bazë të përqindjes së zënies së shtratit, sipas statistikave të SRD, janë të pasqyruara më poshtë:

**Tabela 3. Përqindja e zënies së shtratit**

Nr .	Emërtimet e shërbimeve në SRD	Nr shtreteve	Shfrytezi mi i shtratit 2022	Shfrytezi mi i shtratit 2023	Shfrytezi mi i shtratit 2024	Shfrytezi mi i shtratit 2025
<b>I.</b>	<b>Shërbimi i Patologjisë</b>	<b>130</b>	<b>56.63</b>	<b>58.98</b>	<b>60.59</b>	<b>67.27</b>
A.	Patologjia e pergjithshme	40	82	83.99	85.92	87.86
B.	Neurologjia	30	67.66	64.31	64.09	73.52
C.	Kardiologjia dhe Rean.kar.	40	45.64	44.32	47.64	60.96
1	Kardiologjia	30	42.97	42.91	45.19	58.49
2	Reanimacioni Kardiologjisë	10	53.67	48.52	54.99	68.36
D.	Infektivi	20	24.33	30.32	30.6	29.32
<b>II.</b>	<b>Shërbimi i Kirurgjisë</b>	<b>65</b>	<b>68.32</b>	<b>63.68</b>	<b>65.89</b>	<b>63.95</b>
A.	Kirurgjia e pergjithshme	33	77.25	76.43	73.7	72.26
B.	Ortopedia dhe Traumatol.	20	83.78	68.6	83.59	76.95
C.	ORL,Okulistik,Maxiho-fac.	12	18.01	20.41	14.93	19.43
1	ORL	3	19.18	22.83	18.08	23.84
2	Okulistika	7	16.44	18.59	12.33	17.46
3	Maxiho - faciale	2	21.78	23.15	19.32	19.73
<b>III.</b>	<b>Shërbimi i Maternitetit</b>	<b>85</b>	<b>38.1</b>	<b>35.76</b>	<b>33.7</b>	<b>36.46</b>
D.	Neonatologjia	65	29.95	28.11	27.85	28.09
<b>IV.</b>	<b>Shërbimi i Pediatriisë</b>	<b>60</b>	<b>29.21</b>	<b>36.06</b>	<b>43.26</b>	<b>45.51</b>
	<b>Totali</b>	<b>340</b>	<b>50.14</b>	<b>50.03</b>	<b>51.82</b>	<b>55.08</b>

	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024	Viti 2025
<b>Vizita Ambulatore SRD gjithsej</b>	<b>2,302,026</b>	<b>236,743</b>	<b>24,848</b>	<b>251,641</b>
		33,919		
Spitali	32,353	70,555	34,837	39,098
Poliklinika	73,116	132,269	68,366	65,567
Urgjnca Total	124,737	83,629	145,145	146,976
Urgjenca Path+kirurgji	76,761	42,745	93,485	95,130
Urgjenca Pediatri	42,292	5,895	45,214	44,973
Urgjenca Maternitet	5,687	3,902	6,446	6,873
Paliativ,onkologji,kimio-terapi	3,239	3,902	3,902	4,324

	Pacientë	Ditë qëndrimi	Pacientë	Ditë qëndrimi	Pacientë	Ditë qëndrimi	Pacientë	Ditë qëndrimi
--	----------	---------------	----------	---------------	----------	---------------	----------	---------------

	2022		2023		2024		2025	
<b>Shërbimi Anestezi - Reaminacion</b>	1712	2459	1623	2279	1634	2436	1509	2183
<b>Kirurgji</b>	536	1267	476	1107	489	1283	430	1102
<b>Maternitet</b>	1176	1192	1147	1172	1153	1153	1079	1081

➤ **Materiali i butë dhe afatet e përdorimit që ka aktualisht SRD në zbatim të kontratës.**

Në Tabelën 4 janë paraqitur emërtimet, afatet, sasia, specifikimet teknike dhe përmasat e materialit të butë për kontratën që ka në ekzekutim SRD.

**Tabela 4. Materiali i butë që ka në përdorim SRD, sipas kontratës që ka në ekzekutim**

**Tabela 4.1. Dyshekët që i mbeten në përdorim SRD**

Nr .	Emërtimi	Data e hyrjes në SRD	Njësi a	Sasi a	Nor mati va e përd orim it	Specifikimet teknike	Dimen sionet	Përfun dimi i afatit të përdor imit
1	Dyshek spitalor	Tetor 2017	Copë	300	10 vjet	Dysheku është i njëtrajtshëm (pa ndarje), përbëhet nga dy shtresa sfungjeri brenda, ku njëra anë ka porozitet për qarkullimin e ajrit, me veshje mushama antibakterial dhe antialergjik, dhe ka të shënuar datën e futjes së materialit në përdorim në shërbimin mjekësor.	190×90 ×10 cm	Tetor 2027
2	Dyshek spitalor	Tetor 2020	Copë	79	10 vjet	Dysheku është i njëtrajtshëm (pa ndarje), përbëhet nga dy shtresa sfungjeri brenda, ku njëra anë ka porozitet për qarkullimin e ajrit, me veshje mushama antibakterial dhe antialergjik, dhe ka të shënuar datën e futjes së materialit në përdorim në shërbimin mjekësor.	190×90 ×10 cm	Tetor 2030
3	Dyshek pediatrik (0–5 vjeç)	Tetor 2020	Copë	20	10 vjet	Dysheku është i njëtrajtshëm (pa ndarje), përbëhet nga dy shtresa sfungjeri brenda, ku njëra anë ka porozitet për qarkullimin e ajrit, me veshje mushama antibakterial dhe antialergjik, dhe ka të shënuar datën e	140×70 cm	Tetor 2030

						futjes së materialit në përdorim në shërbimin mjekësor.		
4	Dyshek pediatrik (5–14 vjeç)	Tetor 2020	Copë	50	10 vjet	Dysheku është i njëtrajtshëm (pa ndarje), përbëhet nga dy shtresa sfungjeri brenda, ku njëra anë ka porozitet për qarkullimin e ajrit, me veshje mushama antibakterial dhe antialergjik, dhe ka të shënuar datën e futjes së materialit në përdorim në shërbimin mjekësor.	160×70 cm	Tetor 2030
5	Dyshek për krevat neonatesh reanimacion	Tetor 2020	Copë	12	8 vjet	Dysheku është i njëtrajtshëm (pa ndarje), përbëhet nga dy shtresa sfungjeri brenda, ku njëra anë ka porozitet për qarkullimin e ajrit, me veshje mushama antibakterial dhe antialergjik, dhe ka të shënuar datën e futjes së materialit në përdorim në shërbimin mjekësor.	70×38×8 cm	Tetor 2028
6	Dyshek krevat neonatesh pavion	Tetor 2020	Copë	15	8 vjet	Dysheku është i njëtrajtshëm (pa ndarje), përbëhet nga dy shtresa sfungjeri brenda, ku njëra anë ka porozitet për qarkullimin e ajrit, me veshje mushama antibakterial dhe antialergjik, dhe ka të shënuar datën e futjes së materialit në përdorim në shërbimin mjekësor.	60×35×5 cm	Tetor 2028
7	Dyshek krevat neonatesh (Neonatologji)	Tetor 2020	Copë	10	8 vjet	Dysheku është i njëtrajtshëm (pa ndarje), përbëhet nga dy shtresa sfungjeri brenda, ku njëra anë ka porozitet për qarkullimin e ajrit, me veshje mushama antibakterial dhe antialergjik, dhe ka të shënuar datën e futjes së materialit në përdorim në shërbimin mjekësor.	87×50×10 cm	Tetor 2028
8	Dyshek shtrat vizitash neonate	Tetor 2020	Copë	4	8 vjet	Dysheku është i njëtrajtshëm (pa ndarje), përbëhet nga dy shtresa sfungjeri brenda, ku njëra anë ka porozitet për qarkullimin e ajrit, me veshje mushama antibakterial dhe antialergjik, dhe ka të shënuar datën e futjes së materialit në përdorim në shërbimin mjekësor.	74×74×5 cm	Tetor 2028

Tabela 4.2. Materiali i butë që ka në përdorim SRD, sipas kontratës aktuale

N r.	Emërtimi	Data e hyrjes në SRD	Njësi a	Sasi a	Normati va e përdorimit	Specifikimet teknike	Dimensio net	Lloji i materialit	Përfundimi i afatit të përdorimit
1	Jorgan me vatine	Tetor 2025	Copë	280	5 vjet	Mbushje me fiber sintetike, vatine me tegela ndarëse, veshja e jashtme pambuk e bardhë, me logo SRD dhe datë futjeje në përdorim.	140×180 cm	Fiber sintetike me veshje pambuku	Tetor 2030
2	Jorgan me vatine	Tetor 2022	Copë	159	5 vjet	Mbushje me fiber sintetike, vatine me tegela ndarëse, veshja e jashtme pambuk e bardhë, me logo SRD dhe datë futjeje në përdorim.	140×180 cm	Fiber sintetike me veshje pambuku	Tetor 2027
3	Jastëk krevati	Tetor 2025	Copë	138	5 vjet	Mbushje me fibra sintetike uniforme, kellef pambuku me zinxhir; ngjyrë e bardhë.	40×80 cm	Fiber sintetike me veshje pambuku	Tetor 2030
4	Jastëk krevati	Tetor 2022	Copë	340	5 vjet	Mbushje me fibra sintetike uniforme, kellef pambuku me zinxhir; ngjyrë e bardhë.	40×80 cm	Fiber sintetike me veshje pambuku	Tetor 2027
5	Batanije dimërore	Tetor 2025	Copë	161	5 vjet	Material 100% lesh, ngjyrë pana.	140×180 cm	100% lesh	Tetor 2030

6	Guvertë verore	Tetor 2025	Copë	221	5 vjet	Material 60% poliester dhe 40% pambuk, 240×160 cm, ngjyrë e bardhë. Me përfundimin e afatit të përdorimit nuk do të jetë pjesë e kontratës.	230×160 cm	60% poliester dhe 40% pambuk	Tetor 2030
7	Guvertë verore	Tetor 2022	Copë	754	5 vjet	Material 60% poliester dhe 40% pambuk, 240×160 cm, ngjyrë e bardhë. Me përfundimin e afatit të përdorimit nuk do të jetë pjesë e kontratës.	230×160 cm	60% poliester dhe 40% pambuk	Tetor 2027
8	Mbrojtëse dysheku	Tetor 2025	Copë	377	2 vjet	Material 100% pambuk me veshje impermeabile nga një anë; katër anët me llastik; logo SRD.	210×110 cm	100% pambuk me veshje gomuar	Tetor 2030
9	Mbrojtëse dysheku	Tetor 2024	Copë	202	2 vjet	Material 100% pambuk me veshje impermeabile nga një anë; katër anët me llastik; logo SRD.	210×110 cm	100% pambuk me veshje gomuar	Tetor 2026
10	Çarçaf dysheku	Tetor 2025	Copë	332 0	1 vit	Me tegela në të katër anët; peshë 160–180 gr/m <sup>2</sup> ; ngjyrë e bardhë; logo SRD.	250×150 cm	100% pambuk	Tetor 2026

11	Çarçaf jorgani	Tetor 2025	Copë	769	1 vit	Dy fletë me qepje në tre anët; hapje në fund për futjen e jorganit; peshë 160–180 gr/m <sup>2</sup> ; ngjyrë e bardhë; logo SRD.	200×150 cm	100% pambuk	Tetor 2026
12	Kellef jastëku	Tetor 2025	Copë	135 7	1 vit	Dy fletë me qepje në tre anët; hapje në fund për futjen e jastëkut; peshë 160–180 gr/m <sup>2</sup> ; ngjyrë e bardhë; logo SRD.	40×80 cm	100% pambuk	Tetor 2026
13	Peshqir	Tetor 2025	Copë	184 0	1 vit	100% pambuk; ngjyrë e bardhë.	90×50 cm	100% pambuk	Tetor 2026
14	Çarçaf sallë kirurgjie	Dhjetor 2025	Copë	60	1 vit	Me pale në 4 anët; peshë 180–220 gr/m <sup>2</sup> ; ngjyrë jeshile; logo SRD.	200×150 cm	100% pambuk	Dhjetor 2026
15	Kompresë sallë kirurgjie	Dhjetor 2025	Copë	200	1 vit	Me pale në 4 anët; peshë 180–220 gr/m <sup>2</sup> ; ngjyrë jeshile; logo SRD.	75×90 cm	100% pambuk	Dhjetor 2026
16	Çarçaf sallë lindje	Dhjetor 2025	Copë	120	1 vit	Me pale në 4 anët; peshë 180–220 gr/m <sup>2</sup> ; ngjyrë jeshile; logo SRD.	300×200 cm	100% pambuk	Dhjetor 2026
17	Kompresë sallë lindje	Dhjetor 2025	Copë	360	1 vit	Me pale në 4 anët; peshë 180–220 gr/m <sup>2</sup> ; ngjyrë jeshile; logo SRD.	50×80 cm	100% pambuk	Dhjetor 2026
18	Garza sallë lindje	Tetor 2025	Copë	150	1 vit	100% pambuk methurje 120 gr/m <sup>2</sup> , 8 shtresa të qepura në të katër anët dhe	45×45 cm	100% pambuk	Tetor 2026

						mes, dy rripa anësorë.			
19	Rroba dëshambër pacient adult	Tetor 2025	Copë	—	2 vjet	Me lidhje anash ose mbrapa, me mëngë të shkurtra, të gjera; masa sipas kërkesës së AK; logo SRD; 100% pambuk.	Sipas kërkesës së AK	100% pambuk	Tetor 2027
20	Pizhama burrash	Tetor 2025	Copë	45	2 vjet	Pambuk i plotë; xhaketë me mëngë të gjata; pantallona unisex me llastik në bel; ngjyra dhe gjatesi sipas kërkesës.	Sipas kërkesës së AK	100% pambuk	Tetor 2027
21	Pizhama burrash	Tetor 2024	Copë	90	2 vjet	Pambuk i plotë; xhaketë me mëngë të gjata; pantallona unisex me llastik në bel; ngjyra dhe gjatesi sipas kërkesës.	Sipas kërkesës së AK	100% pambuk	Tetor 2026
22	Fustan (gjumi)	Tetor 2025	Copë	50	2 vjet	Trikotazh 100% pambuk, ngjyra dhe masa sipas kërkesës së AK.	Sipas kërkesës së AK	100% pambuk	Tetor 2027
23	Fustan (gjumi)	Tetor 2024	Copë	133	2 vjet	Trikotazh 100% pambuk, ngjyra dhe masa sipas kërkesës së AK.	Sipas kërkesës së AK	100% pambuk	Tetor 2026
24	Pandofla pacienti	Tetor 2025	Copë	266	1 vit	Material plastik, me gomë poroze, ngjyra dhe numra sipas kërkesës së AK.	Sipas kërkesës së AK	Material plastik	Tetor 2026

**Tabela 4.2 – Materiali i butë për godinën e Pediatriisë që i mbeten në përdorim SRD**

N r.	Emërtimi	Data e Hyrjes në SRD	Njësi	Sasi	Normati va e Përdorimit	Specifiki met Teknike	Dimensio net	Lloji i Materia lit	Përfundimi i Afatit të Përdorimit
1	Jorgan me Vatine Pediatri (0-5 vjeç)	Tetor 2020	Copë	20	5 vjet	Mbushje me fiber sintetike, vatine me tegela ndarëse; veshja e jashtme pambuk, ngjyrë e bardhë; logo SRD dhe data e përdorimit të stampuar. Ky produkt nuk do të jetë më pjesë e kontratës.	100x150 cm	Fiber sintetike dhe pambuk	Ky produkt nuk është kërkuar për t'u zëvendësuar
2	Jorgan me Vatine Pediatri (5-14 vjeç)	Tetor 2025	Copë	60	2 vjet	Mbushje me fiber sintetike, vatine me tegela ndarëse; veshja e jashtme pambuk, ngjyrë e bardhë; logo SRD dhe data e	100x180 cm	Fiber sintetike dhe pambuk	Tetor 2027

						përdorimit të stampuar.			
3	Batanije Dimerore Pediatri	Tetor 2025	Copë	125	5 vjet	Material 100% lesh, ngjyre pana	100x150 cm	100% lesh	Tetor 2030
4	Mbrojtës e Dysheku Pediatri (0-5 vjeç)	Tetor 2024	Copë	35	2 vjet	Material 100% pambuk, një anë impermea bel; me llastik në katër anët; logo SRD	160x90 cm	Pambuk dhe veshje e gomuar	Tetor 2026
5	Mbrojtës e Dysheku Pediatri (5-14 vjeç)	Tetor 2024	Copë	70	2 vjet	Material 100% pambuk, një anë impermea bel; me llastik në katër anët; logo SRD	180x90 cm	Pambuk dhe veshje e gomuar	Tetor 2026
6	Carcaf Dysheku Pediatri (0-5 vjeç)	Tetor 2025	Copë	145	1 vit	Me tegela në katër anët; pesha 160–180 g/m <sup>2</sup> ; ngjyra e bardhë me fileto blu; logo SRD dhe data e përdorimit e stampuar	200x130 cm	100% pambuk	Tetor 2026

7	Carcaf Dysheku Pediatri (5-14 vjeç)	Tetor 2025	Copë	370	1 vit	Me tegela në katër anët; pesha 160–180 g/m <sup>2</sup> ; ngjyra e bardhë me fileto jeshile; logo SRD dhe data e përdorimit e stampuar	220x130 cm	100% pambuk	Tetor 2026
8	Carcaf Manipuli mi Pediatri	Tetor 2025	Copë	300	1 vit	Me tegela në katër anët; pesha 160–180 g/m <sup>2</sup> ; ngjyra e bardhë me fileto jeshile; logo SRD dhe data e përdorimit e stampuar	150x150 cm	100% pambuk	Tetor 2026
9	Carcaf Jorgani Pediatri (0-5 vjeç)	Tetor 2025	Copë	55	1 vit	Dy fletësh, me qepje në tre anët të hapura fundi për futjen e jorganit; pesha 160–180 g/m <sup>2</sup> ; ngjyra e bardhë me fileto blu; logo SRD dhe data e	110x160 cm	100% pambuk	Tetor 2026

						përdorimit e stampuar			
10	Carcaf Jorgani Pediatri (5-14 vjeç)	Tetor 2025	Copë	100	1 vit	Dy fletësh, me qepje në tre anët të hapura fundi për futjen e jorganit; pesha 160–180 g/m <sup>2</sup> ; ngjyra e bardhë me fileto jeshile; logo SRD dhe data e përdorimit e stampuar	110x190cm	100% pambuk	Tetor 2026

**Tabela 4.3 – Materiali i butë për Sherbimin e Neonatologjisë që i mbeten në përdorim SRD**

Nr.	Emërtimi	Data e Hyrjes në SRD	Njësia	Sasia	Normativa e Përdorimit	Specifikimet Teknike	Dimensionet	Lloji i Materialit	Përfundimi i Afatit të Përdorimit
1	Batanije Dimerore Neonate	Tetor 2020	Copë	130	8 vjet	Poliester me mikrofiber (Fleece Polyester), ngjyrë gri	140x110 cm	Poliester me mikrofiber	Tetor 2028
2	Batanije Verore Neonate	Tetor 2020	Copë	130	8 vjet	100% pambuk organik, ngjyra e bardhë	130x110 cm	100% pambuk	Tetor 2028
3	Carcaf Dysheku Neonate	Tetor 2025	Copë	120	1 vit	Me tegela në katër anët; pesha 160–180 g/m <sup>2</sup> ; ngjyra e bardhë me fileto rozë;	120x120 cm	100% pambuk	Tetor 2026

						logo SRD dhe data e përdorimit e stampuar			
4	Carcaf Fanellate Neonate (Cule)	Tetor 2025	Copë	300	1 vit	Material fanellat 100% pambuk, ngjyra e bardhë me fileto rozë në katër anët; logo SRD dhe data e përdorimit e stampuar	120x120 cm	100% pambuk	Tetor 2026
1	Certifikatat e shëndetit dhe mbrojtjes së ambientit që duhet të shoqërohet produkti	Klasa II	STANDARD 100 nga OEKO-TEX®
---	---	----------	----------------------------

#### Veti shitesë:

- Prodhimi + aksesorët - Konstruksioni, aksesorët dhe prodhimi duhet të jenë të përshtatshëm për produktin dhe përdorimin e destinuar.
- Prodhuesi/furnizuesi duhet të dorëzojë certifikatat përkatëse që vërtetojnë vetitë antibakteriale dhe hipoalergjike të produktit.
- Pëlhura që ofron rezistencë ndaj flakës në përputhje me standarde të tilla si ISO 12952-1/2 për ndezshmërinë e tekstileve të shtratit, konsiderohet avantazh i veçantë në mjedise me kërkesa të larta sigurie.
- Dezinfektimi i sipërfaqes - Agjentët dezinfektues të aplikuar duhet të identifikohen nga prodhuesi.
- Filli i ngjyrosur- Të ketë qëndrueshmëri të ngjyrës si produkti bazë (për produktet me ngjyrë).

PANTALLONA UNISEX							
Masat	XS	S	M	L	XL	XXL	3XL

#### 1. SPECIFIKIMET MBI MENAXHIMIN E PROCESIT TË LAVANDERISË:

- a) “Furnizimi i Shërbimit të lavanderise për Spitalin Rajonal Durres” do të bëhet në Spitalin Rajonal Durres.
- b) Operatori ekonomik do të ofrojë shërbimin e tij, nga procesi i larjes së materialit të bute në lavanderi deri tek kompletimi me inventarin e materialit të bute, ndërrimin dhe shtrimin e materialeve në shtratin e pacientit/ shtratin e mjekut roje.
- c) Sipermarresi është i detyruar të disponojë të gjitha kapacitetet larese, dezinfektuese, tharëse, hekurose dhe paketuese
- d) Sipermarresi është i detyruar të bëjë zëvendësimin e materialit të bute, nëse ai është i demtuar, i amortizuar apo në mungesë të inventarit.

- e) Operatori Ekonomik siguron inventarin e materialit te bute te nevojshem, per nje kompletim te rregullt sipas normave te shtratit qe ka SRD, me emertimin/logon perkatese te institucionit kontraktues. Inventari i materialit te bute, ne kuptimin e kesaj kontrate, emertimi, permasat, dimensionet, cilesia dhe normat e perdorimit ne kohe, jane perfshire ne specifikimet perkatese.
- f) Operatori Ekonomik pas plotesimit te normatives se perdorimit per secilin material, do te beje zevendesimin e materialeve sipas specifikimeve te tabelave perkatese te paraqitura ne Specifikimet Teknike.
- g) Sipermarresi do te laje, dezinfektoje, thaje, paketoje, transportoje dhe te shperndaje deri ne pavion bazen e materialit te bute, si dhe do te beje sherbimin e plote deri tek shtrati i pacientit.
- h) Rregullat e shtrimit te shtratit do te behen sipas protokolleve te kujdesit infermieror, manualit te kujdesit spitalore, rregullave te higjenes
- i) Shtrimi/nderrimi i shtratit do te behet me kerkese nga kryeinfermieri i sherbimit/pavionit ne baze te shpeshesise se nderrimit dhe sa here te jete e nevojshme.
- j) Materialet e buta te palara te zonave me rrezikshmeri te ndryshme perhapje infeksionesh duhet te ambalazhohen me thase me ngjyra te ndryshme, por jo thase me ngjyre te verdhe kafe apo te kuqe (te cilat jane ngjyrat qe perdoren per identifikimin e mbetjeve spitalore)
- k) Larja dhe dezinfektimi, ne repartin e lavanderise do te behet ne menyre te perqendruar, duke respektuar te gjitha procedurat dhe protokollet e higjenes, nga marrja ne dorezim e materialit te bute te papaster te ndare sipas nendarjeve dhe zonave te rrezikshmerise (thaset me ngjyre), tek dorezimi i materialit te bute, te lare, te hekurosur dhe te paketuar sipas ketyre protokolleve, deri ne nderrimin/shtrimin e shtratit te pacientit sipas protokolleve infermiore. Pjese e ketij procesi eshte edhe sigurimi i pastrimit te plote kimik-mekanik, ne temperaturat e duhura, dhe i procesit te hekurosjes.
- l) Terheqja dhe dorezimi i inventarit te materialit te bute ne pavione, do te behet me grafik te hartuar nga Sektori i Hotelerise ne baze te kerkesave te kryeinfermiereve te sherbimeve/pavioneve. Grafiku eshte i detyruar te zbatohet nga te dyja palet, dhe ne rastet e ndryshimit te tij, miratimi duhet te behet me nenshkrim nga te dyja palet.
- m) Perdorimi i inventarit te materialit te bute brenda pavionit, behet nga personelit pergjegjes i sipermarresit, nen kontrollin e autoriteti kontraktor, sipas procedurave te meposhtme:
- 1) Çdo ditë, Kryeinfermieri harton flete kerkesen ditore totale per ditën e nesërme per material te bute dhe brenda orës 13:30 e dorezon pranë Sektorit të Hotelerise.
  - 2) Sektori i Hotelerise bazuar në fletë kërkesat ditore, dorezon nje kopje OE për zbatim dhe nje kopje Komisionit te Monitorimit per shperndarjen dhe kolaudimin e materialit te bute.
  - 3) Sektori i Hotelerise, harton pasqyrën përmbledhëse ne “cope” te materialit te bute te palare, dhe ben rakordimet perkatese me OE. Pas rakordimit dhe nenshkrimit nga te dy palet, nje kopje te pasqyres permbledhese te materialit te bute te palare ia dorezon Komisionit te Monitorimit me qellim qe te bej pritjen e tij ditën pasardhese.
  - 4) Komisioni i Monitorimit e pret kete material, sipas pasqyres permbledheses se materialit te bute te palare duke mbajtur proces verbalin perkates per cdo dite ne “cope” dhe “kg”, duke e numeruar, peshuar dhe kolauduar materialin e bute te lare dhe ia dorezon te nenshkruar Sektorit te Hotelerise.
  - 5) Ambienti ku do te behet, pritja e materialit te bute, peshimi, numerimi, magazinimi dhe i gjithe kontrolli i nevojshem percaktohet ne momentin e lidhjes se kontrates dhe do te jete nen administrimin e AK.

- 6) Vetëm pasi të jetë numeruar, peshuar dhe kolauduar nga grupi i monitorimit, materiali i butë është gati për tu shpërndarë nga sipërmarrësi, sipas pasqyres permbljedhese te kerkesave te sherbimeve te perpiluar nga Sektori i Hotelerise bazuar ne kerkesat e kryeinfermiereve.
- 7) Spitali Rajonal Durres likujdon çdo muaj OE, sipas akt rakordimit te hartuar nga Sektori i Hotelerise, i cili bazohet ne proces verbalet ditore (cope dhe kg) te materialit te bute te lare, dhe nenshkruhet nga Sektori Hotelerise, grupi i monitorimit te kontrates dhe OE zbatues.
- 8) Praktika financiare per dokumentimin e sherbimit te ofruar nga OE dorezohet per likujdim ne Sektorin e Finances pas rakordimeve ndermjet sektorit, grupit te monitorimit dhe OE.
- 9) Kur sipërmarrësi nuk bën ndërrimet e materialit të butë të shtratit të pacientit sipas afateve të përcaktuara, me ankesën me shkrim të shërbimit/pavionit, përfaqësuesi i Spitalit përpilon informacionin përkatës duke i bashkëngjitur një proces – verbal, në bazë të të cilit vërtetohet se nuk është kryer shërbimi. Për çdo ditë, shtrati që nuk është ndërruar në afat, sipërmarrësit i mbahet vlefte e llogaritur e materialit të butë të lare që nuk është ndërruar. Në rastet kur mungesa e shërbimit përsëritet, sipërmarrësi i paguan gjobë Spitalit, sa dhjetëfishi i vlerës së shërbimit të munguar të llogaritur në shërbim.
- 10) Proces – verbalet për ndalesat dhe gjobat, i njoftohen OE brenda 5 diteve, i cili ka 30 dite afat per te paraqitur ne Drejtorine e SRD kundershimitet e tij. Jashtë këtij afati, këto proces-verbale do të quhen të pranuar nga palët, dhe sipërmarrësit do ti mbahet vlera perkatese në pagesën mujore të radhës.
- 11) Nese gjate pritjes se materialit te bute te lare i cili kolaudohet nga grupi i monitorimit, vihen re materiale qe nuk plotesojne kushtet higjeno-sanitare apo kushtet fizike sipas specifikimeve teknike perkatese, materiali i bute i lare do te zbritet nga pasqyra permbljedhese e materialit te bute te palare i dites perkatese, i cili pregatitet nga Sektori i Hotelerise.
- 12) Personeli që punësohet nga sipërmarrësi në shërbimin e lavanderisë, brenda territorit të Spitalit, është i detyruar të zbatojë protokollet e kujdesit të higjienës, të kujdesit infermieror, si dhe rregulloren e Spitalit.
- 13) Levrimi i mallit te ri qe duhet te sjelle OE ne fillim te zbatimit te kontrates do te behet nga sipërmarrësi ne Tetor nga data e lidhjes se kontrates dhe do te ripërterihen rregullisht sipas afateve te përcaktuara ne tabelat perkatese. Keto afate do monitorohen nga grupi i pritjes se mallit, i cili do te raportojë ne lidhje me zbatimin nga ana e OE te afateve dhe specifikimeve teknike.
- 14) Punonjësit e shpërndarjes duhet të jenë të pajisur me uniformë si dhe me mjete e shenja dalluese përkatëse të kontraktuesit, me miratim të AK. Punonjësit e OE nuk duhet te kene uniformat me ngjyra te ngjashme apo te njejta me uniformat e unifikuara te AK.
- 15) Kontraktuesi do të zëvendësojë çdo punonjës nëse AK konstaton se personi kryen veprime të jashtëligjshme gjatë ushimit të profesionit të tij ose nuk zbaton protokollet e kujdesit të higjienës, të kujdesit infermieror, si dhe rregulloren e Spitalit. Në rastet kur kjo konstatohet, punonjësi përkatës nuk duhet te punoje me ne ambientet e Spitalit, me kërkesën me shkrim të Drejtorisë së Spitalit, e bazuar kjo e fundit ne proces-verbalin apo informacionin sipas rastit.
- 16) Punonjësit e OE duhet të sillen me edukatë dhe kortezi, si gjatë zhvillimit të shërbimit dhe gjatë qarkullimit brenda ambienteve të SRD.
- 17) Personeli i OE duhet të jetë i pajisur me kontratë të rregullt pune, te kryhet pagesa e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, si dhe të jetë i pajisur me librezë shëndetësore nga Inspektoriati Sanitar Shëndetësor.
- 18) Personeli i OE duhet te respektojne orarin e punes dhe nuk duhet te levizin nga pavioni / sherbimi i caktuar gjate orarit te punes, ne menyre qe te parandaloje perhapjen e infeksioneve spitalore.

- 19) Personeli i OE është kategorikisht i ndaluar të nderhyjë në ofrimin e shërbimit të pacientëve, apo të preke pacientet. Ndërrimi i shtratit të pacientit në rast pamundesie levizje të pacientit do të bëhet nga personeli spitalor
- 20) Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të ushtrojë kontroll në ambjentet e lavanderisë sa herë që e vlerëson të arsyeshme, me apo pa njoftim, por jo më pak se një herë në tre muaj, duke e dokumentuar këtë veprim nepermjet një procesverbali të nënshkruar nga të dy palët.
- 21) Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të ushtrojë kontroll sa herë që e vlerëson të arsyeshme, me apo pa njoftim, lidhur me gjendjen e depove të materialeve të buta nëpër pavione, në prani të përfaqësuesit të Kontraktorit, duke mbajtur procesverbalet përkatës. Shërbimi në depo dokumentohet sipas një regjistri, i cili do të miratohet nga AK.
- 22) Operatori i kontraktuar duhet të ofrojë shërbimin e grumbullimit të të gjithë materialit të butë të papastër në bazë të rregullores së parandalimit të infeksioneve spitalore, transportimin e tij në lavanderi, seleksionimin, larjen, tharjen, hekurosjen, paketimin, transportimin sërisht mbrapsht në Shërbime (ku materiali i larë nuk duhet të ketë kontakt me materialin e palarë për të shmangur infeksionet), deri në ndërrimin dhe shtrimin e shtratit të pacientit në të gjitha shërbimet e SRD-së:
- 23) Operatori ekonomik siguron inventarin e materialit të butë, për një kompletim të rregullt sipas normave të shtratit që ka SRD, me datën e hyrjes në shërbim dhe logon përkatëse të SRD, për secilin artikull: dyshek spitalor, këllëf dysheku, jastëk, këllëf jastëku, batanije, çarçaf dysheku, çarçaf jorgani, jorgan me vatine, kostumet e sallës, peshqirë, përparëse mjeku, kostume infermieri, sanitare, fizioterapeut, teknik imazherie, etj.
- 24) Shpërndarja e materialit të butë në të gjithë shërbimet e SRD-së, sipas grafikëve të përcaktuar nga Sektori i Hotelerisë bëhet nga ora 08:30 deri në orën 15:00.
- 25) Procesi i marrjes në dorëzim të materialit të butë të lare në deponë e magazinimit të perkohshëm në pavion, do të bëhet në mënyrë të rregullt, në prezencë të kryeinfermierit të pavionit/shërbimit ose personi i autorizuar prej tij dhe përfaqësuesit të OE, pas numërimit, kontrollit për hekurosjen, cilësinë e materialit të butë të larë (në bazë të kërkesës të sjellë një ditë më parë në Sektorin e Hotelerisë).
- 26) Shtrimi i shtratit të pacientit në pavion, si për shtrimet e reja ashtu edhe shtrimet urgjence, nga ora 07:00 deri në orën 15:00 do të jete nën përgjegjësinë e operatorit ekonomik, sipas kërkesë së pavionit, ndërsa nga ora 15:00 deri në orën 07:00 të ditës pasardhëse do të jete nën përgjegjësinë e personelit të SRD-së. Për Shërbimet e Urgjencave dhe Reanimacionet OE do të ofrojë 24 orë shërbim.
- 27) Terheqja e materialeve të ndotura nga pavioni, do të bëhet nga sipërmarrësi deri në orën 15:00.
- 28) Shërbimi do të ofrohet nga personeli i OE gjatë gjithë javës, prej ditës së hënës deri ditën e dielës, duke përfshirë edhe ditët e festave, gjatë 8 orëve, ndërsa për Shërbimet e Urgjencës e Reanimacionit do të jete 24-orësh,
- 29) Kryeinfermieri i pavionit/shërbimit bën kërkesë për material të butë të lare duke parashikuar nevojat e shërbimit/pavionit edhe për fundjavën edhe ditët e festave.
- 30) Sipërmarrësi ia dorëzon materialin e butë kryeinfermierit të pavionit në bazë të grafikut të hartuar nga Sektori i Shërbimeve të Hotelerisë. Për çdo rast, dorëzimi i materialit të butë do të bëhet vetëm pasi ky material i butë të jetë peshuar, numëruar dhe koaluduar nga grupi i monitorimit të kontratës.
- 31) Kryeinfermieri i pavionit ka të drejtën të bëjë kontrollin për larjen, hekurosjen, cilësinë e materialit të butë dhe në rast konstatimi të materialit të butë defektos ose të papastër, e kthen mbrapsht duke e pasqyruar në procesverbal. Ky proces verbal duhet të dorëzohet në Sektorin e Hotelerisë dhe të ketë të saktësuar numrin e materialit të butë të kthyer mbrapsht nga Kryeinfermieri i pavionit.

- 32) Në raste të konstatimit të mungesave dhe/ose dëmtimit të materialit të butë për periudhën e lënë nën administrim e personelit të Spitalit, do të mbahet një procesverbal, i firmosur nga ana e Kryeinfermierit/infermiereit turnit dhe përfaqësuesit të OE, një kopje e të cilit do të dorëzohet në Sektorin e Hotelerise dhe sipërmarrësi do të bëjë menjëherë zëvendësimet përkatëse.
- 33) Kryeinfermieri i pavionit do të evidentojë dhe konfirmojë në mënyrë të vazhdueshme lidhur me shërbimet që kryhen, cilësinë dhe sasinë e kërkuar, si dhe për çdo parregullsi do informojë Sektorin e Hotelerise.
- 34) Në të gjitha rastet, kur shërbimet kanë nevojë për material të butë shtesë, vetëm pas miratimit të Sektorit të Hotelerise, grupi i monitorimit të kontrates dhe OE do të proçedojë me dorëzimin e materialit të butë shtesë të kërkuar nga shërbimi.
- 35) Për raste të gjendjes së jashtëzakonshme, epindemive apo pandemive, lavanderia do të funksionojë sipas kushteve që vendos Drejtoria e SRD-së.
- 36) Zevendesimi i inventarit të dëmtuar, bëhet nga sipërmarrësi duke ruajtur përmasat, dimensionet dhe përbërjen fillestare sipa Specifikimeve Teknike të kontrates.
- 37) Kontraktuesi do të largojë vetë mbetjet urbane që gjenerohen gjatë ofrimit të shërbimit.
- 38) Për mjedisin që do të merren në përdorim, sipërmarrësi duhet të paguajë qeranë sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Keto mjedise nuk mund të tjetërsohen. Kur janë të nevojshme të bëhen përshtatje është i domosdoshem të merret miratimi me shkrim nga SRD-ja.
- 39) Te gjitha kostot për ofrimin e shërbimit të lavanderise dhe hotelerise në SRD, janë përgjegjesi dhe do të sigurohen nga vete sipërmarrësi.
- 40) Inventari i materialit të butë i shtratit të pacientëve dhe i veshjeve të personelit mjekësor janë në ngarkim të sipërmarrësit dhe administrohen nga ai deri në përfundim të kontratës së shërbimit. Me përfundimin e kontratës së shërbimit, i gjithë inventari i butë në përdorim do të mbetet AK.
- 41) Materiali i butë që do të plotësojë normativat, do të tërhiqet nga OE ekzekutues i kontrates, pas tjetërimit nga Sektori i Hotelerise, duke u zëvendësuar sipas plotësimit të afateve të normativave të ndërrimit.
- 42) Autoriteti kontraktor ka të drejtë të kontrollojë në prani të përfaqësuesit të sipërmarrësit, dhe të përpilojë akt kontrolli nga sektorë të ndryshëm të saj, në bazë të programeve të punës, për të evidentuar çdo parregullsi në lidhje me kryerjen e shërbimit, sasinë e materialit të butë të dorëzuar duke rakorduar dhe mbajtur procesverbale përkatëse të shërbimit.
- 43) I gjithë materiali i butë në përdorim, me përfundimin e kontratës, i dorëzohet Spitalit Rajonal Durres pa kundërpaguesë.
- 44) Sipërmarrësi OE, menjëherë pas lidhjes së kontrates do të marrë në dorëzim materialin e butë që zoteron aktualisht SRD.

**Shtojca 9**

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)*

*(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)*

**FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT**

**Shërbimi që kërkohet: “Furnizimi i Shërbimit të lavanderisë për Spitalin Rajonal Durrës”**

<b>Shërbimi</b>	<b>Përshkrimi</b>	<b>Shuma totale për 48 muaj</b>	<b>Vendi i ekzekutimit</b>	<b>Afati i ekzekutimit</b>
“Furnizimi i Shërbimit të lavanderisë për Spitalin Rajonal Durrës”	Sipas specifikimeve teknike dhe termave të referencës	824,935.51 kg	Në pavionet e Spitalit Rajonal Durrës	Sipas nevojave të AK, brenda periudhës së vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër

**Afatet e ekzekutimit:** 48 muaj nga nënshkrimi i marrëveshjes kuadër.

Çdo ditë në varësi të kërkesave të Autoritetit Kontraktor

## Shtojca 10

### FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: **“Furnizimi i Shërbimit të lavanderisë për Spitalin Rajonal Durrës”**

Detyrat:

#### **DISA NGA RREGULLAT BAZE PER QARKULLIMIN E MATERIALIT TE BUTE NE PAVIONET E SPITALIT RAJONAL DURRES, PER PARANDALIMIN DHE ELIMINIMIN E INFEKSIONEVE SPITALORE**

Rregullat per eleminimin e infeksioneve spitalore, mbeshteten ne manualet e kujdesit spitalor, ne manualet e parandalimit te infeksionit nozokomial, ne rregullat e higjenes, ne ligjin e inspektoriatit sanitar shteteror, ne protokollet e kujdesjeve infermierore si dhe ne praktikat me te mira te spitaleve, ne sherbimin dhe kujdesin spitalor.

#### **Pershkrimi:**

1. Personeli i sipermarresit, qe kryen proceset per nderrimin/shtrimin e shtratit te pacientit ashtu dhe te terheqjes se materialeve te ndotura, duhet te kete veshje identifikuese, te njohur nga autoriteti kontraktor. Ai duhet te zbatoje protokollin e kujdesit infermieror ne nderrimin dhe shtrimin e shtratit te pacientit, si dhe rregullat e higjenes.
2. Materiali i bute duhet te manipulohet me doreza josterile nje perdorimshe, ai nuk duhet transportuar duke e mbajtur ne dore nga personeli apo lene ne toke.
3. Mbledhja e materialeve te papastra, do te behet ne nje vend te sherbimit, te percaktuar nga autoriteti kontraktor, ne thaset identifikues me ngjyren dhe pershkrimin perkatese te llojit te materialit te ndotur, te cilet do te qendrojne aty deri ne momentin e dorezimit.
4. Thaset e rrobave mbushen deri ne 2/3, mbyllen krejtesisht dhe vendosen ne dhomen apo vendin e parashikuar ne sherbim per depozitimin e materialeve.
5. Thaset nuk duhet te terhiqen mbi dysHEME.
6. Karroca per materialin e bute te palare, sherben per mbajtjen e thaseve me ngjyra, per depozitimin e materialeve te ndotura nga nje shtrat ne tjetrin. Karroca eshte e paisur me rrota.
7. Karroca e materialeve, nuk futet ne dhomen e pacientit. Ne momentin e nderrimit te pacientit, duhet te largohet cdo objekt duke bere kujdes per aparatet dentare, auditiv, stilolaps apo material tjeter prerës.
8. Sipermarresi terheq nga pavioni inventarin e mbyllur me thaset me ngjyra te percaktuara sipas zonave dhe normave higjeno-sanitare, per larje dezinfektim nga personi i autorizuar, dhe ne te njejten kohe dorezon ne pavion inventarin e paster te hekurosur dhe te paketuar.
9. Inventari qe merret ose dorezohet, eshte gjithmone i palosur dhe i paketuar.

10. Veshjet e punes se personelit shendetesor:
- a. Veshjet e personelit shendetesor te ndotura, me xhepat e zbrasur vendosen ne thesin qe ndodhet tek dhoma e zhveshjes se personelit.
11. Rast i vecante i materialit te kontaminuar “me rrezik mikrobiologjik”:
- a. Ky material vendoset fillimisht në një qese plastike dhe më pas në një thes rrobash të bojeqiell: material i kontaminuar me gjak apo lëngje biologjike.
  - b. E njëjta procedurë do të zbatohet edhe për materialin e kontaminuar (salmonela, shigela, viruse intestinale, chlostridium difficile, etj.) apo kur vihet re prania e ekto parazitëve si cimka, morra etj.
12. Qarkullimi:
- a. Mbledhja e materialit të ndotur kryhet nga punetori i shërbimit të lavanderisë çdo mëngjes.
  - b. Shpërndarja e materialit të pastër për hospitalizim dhe veshjet e punës, bëhet në çdo shërbim nga personeli i autorizuar nga sipërmarresi.
  - c. Në asnjë rast materialet e bute nuk hidhen nga shërbimet në koshat e mbetjeve të SRD apo nga lartësia.
13. Përkujdesje:
- a. Lani duart në çdo ndërrim shtrati nepermjet kesaj procedure: kryeni një larje të thjeshtë dhe më pas një ferkim hidroalkoolik të duarve, pasi të keni manipuluar materialet e pista.
  - b. Lani çdo ditë karrocën e mbajtjes së thasëve të materialit të ndotur, mos lani asnjëherë materialet në shërbim, si dhe mos merrni asnjëherë material për t’u larë në shtëpi.

Shpërndarja: Në pavionet e Spitalit Rajonal Durrës, sipas specifikimeve teknike

Vendi i kryerjes së shërbimeve: Në pavionet e Spitalit Rajonal Durrës, sipas specifikimeve teknike

**Shtojca 11**

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

**FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT****1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT****OFERTUESI DEKLARON SE:**

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar

*Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 12.*

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

### **Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

- Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 12;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 5;*

### **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

#### **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

Sipas kritereve të përgjithshme të kualifikimit, të përcaktuara në pikën 1, Shtojca 11 të DST.

#### **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2023-2024-2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomike arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare (2023, 2024, 2025), të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41 të Ligjit Nr. 10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

### 2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 39 % të vlerës së fondit të limitit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjisllacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjisllacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të ketë në pronësi, qira ose në përdorim **të paktën 1 (një) ambient, ku shtron veprimtarinë për kryerjen e shërbimit lavanderisë objekt prokurimit.**

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- dokumentacionin që vërteton pronësinë, ose qiramarrjen, ose huapërdorjen (certifikatë pronësie/ kontrata qiraje/ kontrata huapërdorje/ çdo dokument tjetër të vlefshëm, me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).
- akt miratimi higjieno – sanitar për këtë ambient, lëshuar nga organi kompetent i ngarkuar me ligj.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues, duhet të jetë i pajisur me leje mjedisore të Tipit B “Pastrim kimik”, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB), për vendin ku ushtron këtë aktivitet, në fushën e objektit të prokurimit.

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë dhe të paraqesë certifikatë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, dhe të jetë e vlefshme, si më poshtë si më poshtë:

- **SSH EN 14065:2016** mbi “Sistemin e kontrollit të Biokontaminimit”, ose ekuivalente/ të barazvlefshme;

2.3.5 Operatori/ët ekonomik pjesëmarrës për të realizuar shërbimin objekt prokurimi, duhet të ketë minimalisht 42 (dyzet e dy) persona të punësuar, në profilet sipas tabelës si mëposhtme:

NR.	Stafi	Nr.
1	Përgjegjës Shërbimi	2 (dy)
2	Punëtore në Lavanderi	10 (dhjetë)
3	Punonjës Shërbimi në Reparte në AK	27 (njëzet e shtatë)
4	Shofer/Punëtor ngarkim shkarkimi	3 (tre)
	<b>Totali i punonjësve</b>	<b>42 (dyzet e dy)</b>

a) Përgjegjësi i shërbimit, duhet të jetë profesion kimist/bioteknolog/inxhinier mjedisi/ duke përfshirë edhe kualifikime të tjera ekuivalente, dhe duhet të ketë eksperiencë pune të ngjashme të paktën 1 (një) vit.

Për Përgjegjësin e shërbimit, OE duhet të paraqesë:

- Kontratë individuale pune (e vlefshme), si Përgjegjës shërbimi;
- Diplomë e arsimit të lartë;
- Librezë pune/ deklarata e kontributeve të sigurimeve shoqërore individuale e lëshuar nga e – albania/ cv dhe/ose çdo dokumentacion tjetër që vërteton ekspseriencën e kërkuar.

b) Për punonjësit në pikat 2, 3 në tabelën më sipër, të paraqitet kontratë individuale pune (e vlefshme) përkatëse.

*Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 12 të DT.*

Dokumentet provuese të kërkuar më sipër, do të paraqiten nga të gjithë kandidatët e kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të deklarojë se disponon, makinerite, dhe pajisjet, si më poshtë:

Nr.	Emërtimi	Njësia	Sasitë minimale per kapacitetin 500-750 kg/dite
<b>NE AMBIENTIN E LAVANDERISE</b>			
1	Makineri Profesionale Industriale Larëse me:	Copë	2

	· Kabinet inox		
	· Kazan inox		
	· Plotesisht e programueshme		
	· Qasje e lehte ne te gjitha anet		
2	Makine larese me dy porta (barrier larese profesionale)	Copë	1
	· Me sistem kalimi me dere te dyfishtë ngarkimi per ndarjen midis zonave te kontaminuara dhe te pastra		
	· Kabinet inox		
	· Kazan inox		
	· Plotesisht e programueshme		
	· Qasje e lehte ne te gjitha anet		
3	Makinë Tharëse Profesionale	Copë	3
	· Kabinet inox		
	· Kazan inox		
	· Plotesisht e programueshme		
	· Qasje e lehte ne te gjitha anet		
4	Makineri Hekurose (Rul) Profesionale	Copë	2
5	Makineri Paketimi Profesionale për paketim rrobash	Copë	1
<b>PER AMBIENTET E SRD</b>			
6	Kosha për grumbullimin dhe transportimin e materialit te bute te palare	Copë	20
7	Karrela për transportin e materialit te bute te lare deri ne pavion	Copë	12
8	Karroca Sherbimi per nderrimin ne pavione te materialit te bute tek shtrati i pacientit	Copë	12
9	Peshore Elektronike mbi 100 kg	Copë	1

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri, duhet të paraqitet:

dokumentacion për pajisjet dhe instrumentet e mësipërme, që vërtetojnë se, këto pajisje dhe instrumente i ka në pronësi, ose me qera, ose me huapërdorje (fatura blerje / dokumente zhdoganimi / kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / kontratë dhurimi / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 12 të DT.*

*Dokumentet provuese të kërkuar më sipër, do të paraqiten nga të gjithë kandidatët e kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.*

2.3.7 Operatori ekonomik në lidhje me materialin e butë të përcaktuar në specifikimet teknike, duhet të plotësojë tabelën e mëposhtme:

			SRD	
Nr.	Emertimi i produktit	Vendi i origjinës	Skede teknike/katalog	Certifikatë konformiteti ose cilësi CE/ekuivalent akredituar
1	Dyshek			
2	Këllëf dysheku			
3	Jastëk			
4	Këllëf jastëku			
5	Çarçaf shtrati i sipërm			
6	Çarçaf shtrati i poshtëm			
7	Çarçaf zarf			
8	Batanije			
9	Jorgan			
10	Robdishanë pacienti për kirurgjinë e adulteve			
11	Robdishanë pacienti për kirurgjinë e pediatriisë			
12	Bizhame pacienti			
13	Pandofla pacienti për adultët			
14	Pandofla pacienti për pediatriinë			
15	Përparëse mjeku			
16	Kostume personlei mjekësor (Infermier)			
17	Kostume personlei mjekësor (Infermier pediatrie)			
18	Kostume sanitare			
19	Peshqirë urgjence dhe kabinete			
20	Kostum fizioterapist			
21	Kostum tekni imazherie			

21	Kostum koordinator			
22	Kostum psikologu dhe punonjës social			
23	Kostum arkëtar dhe receptionist			
24	Kostum kujdestar dhe barrelambajtës			
25	Kostum ekipi salle			

2.3.8 Operatori Ekonomik duhet të dorëzojë dokumentacion teknik mbi produktin lares që do të përdoren për larjen e materialeve të buta “me ndotje spitalore” sipas klasifikimit në Termat e Referencës shtojca 10 e DST:

- Material i kontaminuar”
- Materiali i kontaminuar, nga një pacient pas ekzaminimit në mjeksinë nukleare.
- Material i konsideruar “me rrezik mikrobiologjik”
- Material i pisët”

Për detergjentet e pastrimit Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- I. Skedat teknike ose katalog të lëshuar nga prodhuesi i produktit, shoqëruar me Certifikatën e Konformiteti ose Cilesia CE për keto lloj produktesh.
- II. Autorizim/Dokument ekuivalent lëshuar nga prodhuesi ose distributori i autorizuar nga prodhuesi, me anë të cilit vërtetohet se ofertuesi ka siguruar furnizim të rregullt të detergjentëve që do të përdoren për larjen e materialeve të buta “me ndotje spitalor”
- III. Tabelen me produktet dhe emertimet që do të përdoren si me poshte vijon:

Materialet e pastrimit				SRD
Nr.	Emërtimi i produktit që do të lahet	Vendi i origjines së produktit të pastrimit	Lloji/Emertimi I detergjentit	Certifikatë konformiteti ose cilësie CE/ekuivalent akredituar
1	Material i kontaminuar			

2	Materiali i kontaminuar, nga një pacient pas ekzaminimit në mjeksinë nukleare			
3	Material i konsideruar “me rrezik mikrobiologjik”			
4	Material i pisët”			

2.3.9 Operatori ekonomik duhet të disponojë minimumi 2 (dy) mjete transporti, me qëllim transportin e materialit të butë, të cilin duhet ta ketë në pronësi, huapërdorje ose me qira.

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri, duhet të paraqitet:

- dokumentacion qe i ka në pronësi, ose me qera, ose me huapërdorje (fatura blerje / dokumente zhdoganimi / kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / kontratë dhurimi / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).
- Leja e qarkullimit të mjetit, policë sigurimi, certifikatë kontrolli teknik, taksa vjetore.

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 12 të DT.*

*Dokumentet provuese të kërkuar më sipër, do të paraqiten nga të gjithë kandidatët e kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.*

2.3.10 Operatori ekonomik, duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër kryerjen e shërbimeve, nga punonjës të pajisur me uniformën e punës, me materiale/ pajisje mbrojtëse personale për shëndetin dhe sigurinë teknike në punë.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

**Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar nga një shtet të huaj.**

**Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.**

**Shtojca 12***(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT**

I. Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ në cilësinë e \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik  
 \_\_\_\_\_ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

**PJESA I: A. INFORMACION NË LIDHJE ME OPERATORIN EKONOMIK**

<b>Identifikimi</b>	<b>Përgjigjja</b>
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	----- ---

**B: DEKLARATË**

**Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)**

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- **Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Shërbimet/ Mallrat e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

- **Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

## Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

### A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:

<p>etj.</p> <p>nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.</p> <p>Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p> <p>_____</p>
<p>Operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i></p> <p>_____</p>
<p>Operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.</p>

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

## **B: DEKLARATA “Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura”**

Në cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, **Deklaroj Se:**

Jam në dijeni të pasojave që vinë ndaj meje lidhur me këtë Deklaratë, në respektim të ligjit nr. 9121/2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

Kam përgatitur ofertën në mënyrë të pavarur, pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër<sup>8</sup>.

Në veçanti, pa kufizuar si më lart, nuk kam pasur kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent me qëllim cënimin e konkurrencën, në lidhje me:

- a) çmimet;
- b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
- c) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
- d) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.

Nuk kam pasur marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent, me qëllim cënimin e konkurrencës, në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë.

<sup>8</sup> Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që: a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor; b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.

Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura, me qëllim cënimin e konkurrencës, në çdo mënyrë qoftë, konkurrentëve të tjerë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj.

